

24 shkurt 2026,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2026, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.27/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KB Rahoveci 029 për shtyrjen e ndeshjes së Xhiros XXII ndërmjet KB Rahoveci 029 dhe KB Bashkimi, e cila ishte planifikuar të zhvillohet më 07.03.2026. Sipas kërkesës dhe pajtueshmërisë ndërmjet klubeve, ndeshja kërkohet të zhvillohet më 08.03.2026.

II. Komisioni i Garave, pas shqyrtimit të kërkesës dhe duke u bazuar në nenin 11.11 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, edicioni 2025/2026, **MIRATON** kërkesën e KB Rahoveci 029 për shtyrjen e ndeshjes.

III. Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit të tij.

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me Vendimin Nr. 27/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

(a) KB Rahoveci 029 ka paraqitur kërkesë për shtyrjen e ndeshjes për shkak se më datë 07.03.2026 palestra “Mizahir Isma” është e rezervuar dhe e zënë deri në orët e mbrëmjes për aktivitete të organizuara nga Komuna e Rahovecit, gjë që e bën të pamundur zhvillimin e ndeshjes sipas orarit të paraparë. Po ashtu, KB Bashkimi ka shprehur pajtimin për ndryshimin e datës së zhvillimit të ndeshjes.


(b) Kërkesa e KB Rahoveci 029 është në përputhje me nenin 11.11 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, edicioni 2025/2026.

Andaj, duke u bazuar në faktet e lartcekura dhe dispozitat përkatëse, Komisioni i Garave vendosi që kërkesa të miratohet.

Komisioni i Garave:


Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës***KËSHILLË JURIDIKE:***

Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.